

STATUTI

PARTIJA E SERBEVE TE KOSOVES

Dispozitat themelore

Neni 1.

Partija e serbeve te kosoves është organizatë politike e formuar sipas rregullave të përgjithshme dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, me qëllime të veqanta të përcaktuara me Programin e Partija e serbeve te kosoves të miratuar në Kuvendin Themelues të mbajtur me 06.04.2017. në Leposaviq.

Neni 2.

Me Statutin e Partija e serbeve te kosoves (në tekstin e mëtutjeshëm: PKS) rregullohet organizimi, qëllimet dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të PKS, detyrimet dhe të drejtat e anëtarëve, dhe të gjitha qështjet tjera me rëndësi për punë dhe funksionim të PKS.

Qëllimet e PKS

Neni 3.

Qëllimi i partisë është realizimi i parimeve të përfshira në Programin e PKS e cila garanton sundimin e ligjit, demokracinë parlamentare dhe lirinë njerëzore.

Parimet themelore të organizimit dhe funksionimit

Neni 4.

Organizimi dhe funksionimi i partisë bazohen në ndërlidhjen e parimeve vijuese:

1. organizimit territorial dhe funksional të Partisë;
2. organet autonome dhe përgjegjësitë e tyre;
3. vendim marje demokratike dhe të drejtat e minoriteteve;
4. ndërlidhjes së organeve shtetërore në të cilat marim pjesë anëtarët e Partisë;
5. inicijativës së lirë dhe vendim marrjës së drejtë dhe ekzekutimin e vendimeve.

Përfaqësimi dhe avokimi

Neni 5.

Partija e serbeve te kosoves e përfaqëson dhe avokon Kryetari i saj.

Në mardhëniet e PKS me Zyrën për regjistrimin e partive politike të Komisionit Qëndrorë Zgjedhorë të Kosovës lidhur me financimin e Partisë, PKS e përfaqëson personi i autorizuar për financa.

Emri, adresa, vula dhe shenja

Neni 6.

Emri plotë i Partisë është: PARTIJA E SERBEVE TE KOSOVES, ndërsa shkurtesa e emërimit: PKS.

Selia e Partisë është: Leposaviq rruga Dositeja Obradoviqa numër 55.

Vula e Partisë është në formë rrethore, diametric 30 mm, në qendrën e së cilës gjindet teksti: "PKS", ndërsa në pjesën unazore të vulës teksti: "Partija e Serbeve te Kosoves", i shkruajtur në anën e majtë të vulës me shkronja çirilicë dhe në anën e djathtë me shkronja latine.

Shenja e partisë është në formë rrethore në të cilin dominojnë ngjyra e kuqe, kaltërt, verdhë dhe e bardhë, shkronjat PKS të cilat janë akronim i Partisë si dhe emërtimi i Partisë është i shkruar me shkronja çirilicë dhe latinisht.

Akronimi është i shenuar me shkronja çirilicë.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Neni 7.

Partija e Serbeve te Kosoves për anëtarësimin e saj ligjorë ose për statusin e vëzhguesit në ndonjë nga organizatat ndërkombëtare do të merr vendime nga organet e partisë (anëtarët e Kryesisë së partisë).

Anëtarësimi në PKS

Neni 8.

Anëtar i PKS mund të jetë çdo qytetarë i moshës madhore me të drejtë vote në teritorin e Republikës së Kosovës, i cili e pranon Programin dhe Statutin e Partisë dhe i cili nuk është anëtarë i ndonjë organizate tjetër politike.

Neni 9.

Anëtarësimi në Parti fillon me dorëzimin e regjistrimit të nënshkruar këshillit lokal, këshillit veprues lokal ose përfaqësuesit lokal.

Këshilli lokal, këshilli veprues lokal ose përfaqësuesi kanë obligim që menjëherë, më së voni në afat prej 7 ditëve prej pranimit të regjistrimit, ta dorëzojnë te këshillit komunal, këshillit veprues komunal, gjegjësisht përfaqësuesit komunal, i cili në 15 ditët e ardhshme nga pranimi i regjistrimit mund të vendosin lidhur me anëtarësimin.

Në vendimin lidhur me anëtarësimin kandidati mund të dorëzojë ankesë në këshillin e Kryesisë në afat prej 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Çdo anëtarë i Partisë mund të kundërshtojë pranimin në anëtarësim në afat prej 6 muajve nga data e anëtarësimit duke dorëzuar ankesën në Kryesi.

Anëtarësimin e plotë në Parti e miraton Këshilli Drejtues.

Neni 10.

Anëtarët e Partisë kanë të drejtë të:

1. zgjedhin dhe të janë të zgjedhur pas 6 muajve të pranimit në anëtarësimin në të gjitha organet e PKS;
2. marrin pjesë të barabartë në aktivitetet e PKS;
3. shprehë lirish mendimin e tyre në kornizat e PKS;
4. marrin pjesë në procedurën e zgjedhjes së kandidatëve lokal të Partisë për organet qeveritare në Kosovë;
5. marrin iniciativat dhe të japin propozime;
6. marrin mbrojtjen e PKS nëse është i kërcënuar për arsye të kryerjes së aktiviteteve të partisë;
7. kërkojnë interpretimin e Statutit nga organet kompetente;
8. gëzojnë të drejtat tjera të parapara me Statut dhe aktet themelore të PKS.
9. anëtarët e regjistruar të partisë politike duke përfshirë edhe zyrtarët e saj, nuk janë përgjegjës për borxhet e partisë.

Neni 11.

Anëtari i Partisë është i obliguar që të:

1. Respektoj statutin dhe vendimet e organeve të PKS;
2. Kontribojë në fushatën zgjedhore për PKS;
3. Paguajë anëtarësimin;
4. Mbrojë dhe të përparojë nderin e PKS
5. Përfaqësojë dhe realizojë qëndrimet politike të PKS;
6. Përbushë edhe obligimet tjera të cilat janë në kuadër të statutit dhe akteve themelore të PKS;

Neni 12.

Anëtarësimi në PKS përfundon me largimin nga Partija, anëtarësimin e njëkohësishëm në ndonjë parti tjetër politike ose iniciativë qytetare, me shlyerjen nga evidenca partiake sipas vendimit të organeve të partisë dhe me vdekjen e anëtarit.

Pyetjet në lidhje me anëtarësimin dhe përfundimit të anëtarësimit rregullohen me aktet e veqanta të cilën e miraton Këshilli Drejtues.

Neni 13.

Statusi i anëtarit të nderit të PKS-a mund ti dorëzohet individëve për shkak të kontributit të jashtëzakonshëm në punën e Partisë ose për merita në fushat e veprimit, zhvillimit dhe promovimit të demokracisë dhe parimeve tjera për të cilat PKS angazhohet.

Statusin e anëtarit të nderit mund ti dorëzohet anëtarit i cili është i kyqyr në punën e partisë minimum tri vite në kontinuitet me përbushje paraprake të kushteve të cekura.

Vendimin për dorëzimin e statusit të anëtarit të nderit e miraton Këshilli Drejtues i Partisë, me propozim nga Kryetari i Partisë.

Të drejtat e minoriteteve

Neni 14.

Anëtarët e PKS të cilët nuk pajtohen me vendimin e shumicës, kanë të drejtë që edhe më tutje të mbrojnë mendimin e tyre në kuadër të organeve të Partisë.

Anëtari i PKS nuk mund të ftohet në përgjegjësi për shkak të shprehjes së mendimit të tij ose për votimin në kuadër të organeve të Partisë.

Përgjegjësitë e anëtarëve

Neni 15.

Për veprimet të cilat i shkaktojnë dëme nderit dhe interesave të PKS, anëtari do të përgjigjet politikisht dhe me masa disiplinore, por në qoftëse i ka shkaktuar edhe dëme financiare parties mund të përgjigjet për të njejtat edhe para organeve të drejtësisë.

Organizimi dhe organet e PKS

Neni 16.

Partia është e organizuar teritorialisht në mënyrën siq vijon:

Organizatën e Partisë e përbëjnë organizatat lokale, komunale dhe qytetare në teritorin e të cilës anëtarët e Partisë kanë vendvotimin, gjegjësisht vendbanimin.

Partia mund të ketë edhe degët e themeluara jashtë vendit. Statusi i këtyre degëve rregullohet me aktet të cilat i miraton Këshilli Kryesisë, me propozim të Kryesisë.

Organet e Partisë

Neni 17.

Organet e Partisë janë: Kuvendi, Këshilli Kryesisë, Kryetari, Nënkrjetarët, Kryesia dhe komisioni Statuorë. Mandati i të gjithë organeve të zgjedhur të Partisë zgjatë katër vite.

Kuvendi

Neni 18.

Kuvendi është organi më i lartë i vendim marrjës në Parti.
Kuvendi mund të jetë zgjedhorë dhe punues.
Kuvendi zgjedhorë mund të jetë i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.
Kuvendi i rregullt është zgjedhorë dhe mbahet sipas rregullave çdo 4 vite.
Kuvendi i jashtëzakonshëm mbahet kur këtë e detyrojnë rrethanat e veçanta.
Kuvendi i jashtëzakonshëm thirret me propozimin e këshillit të kryesisë, me përkrahje (50% plus 1 votë).
Kuvendi punues mbahet çdo vitë.

Neni 18a.

Kuvendin e Partisë e thërret Kryetari i Partisë ose Këshilli Kryesisë me vendim të shumicës së anëtarëve.
Kryetari i Partisë e hapë mbledhjen e Kuvendit.
Kuvendin e udhëheqë Kryesia punuese mandati i të cilëve është i limituar vetëm në mbledhjen e Kuvendit të cilën e kryeson (kryesinë punuese e përbëjnë : Kryetari partisë, nënkryetarët e parties dhe nga një përfaqësues i deleguar nga ana e organizatës së rinisë të partisë dhe nga ana e forumit të gruasë të partisë) .
Vendimi për thirrjen e Kuvendit shpallet një muaj para mbajtjes së kuvendit zgjedhorë, gjegjësisht 15 ditë para se të mbahet kuvendi punues.
Delegatët për Kuvend duhet të janë të informuar për mbajtjen e kuvendit dhe rendin e ditës në të njejtën kohë.
Kuvendi ka legjitimitet kur mer pjesë gjysma nga numri i gjithëmbarshtëm i delegatëve plus një.
Me pregaditjet e Kuvendit udhëheq këshilli Organizativ të cilin e emëron Kryetari i Partisë.

Neni 19.

Kuvendi:

1. miraton, ndryshon dhe plotëson Programin dhe Statutin e Partisë dhe forcon strategjinë e PKS. Ndryshimet dhe plotësimet e Programit dhe Statutit bëhet me votimin në Kuvendin e rregullt ose të jashtëzakonshëm nëse për këtë votonë shumica e delegatëve të pranishëm të Kuvendit të Partisë;
2. shqyrton dhe miraton raportin e Kryetarit të Partisë për punën e Partisë në periudhën ndërmjet dy Kuvendeve;
3. zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin e Partisë, nënkryetarët e Partisë, Sekretarin Gjeneral të Partisë, 11 anëtarët e përhershëm të cilët e përbëjnë këshillin e Kryesisë në mënyrë demokratike dhe transparente çdo 4 vite;
4. miraton Rregulloret.
5. kuvendi mund të vendosë për të gjitha qështjet nga kompetenca e organeve tjera të Partisë.
6. kuvendi nxjerr vendimin për përkatësinë e "PKS" me ndonjë parti tjetër politike në kuvendin e rregullt ose të jashtëzakonshëm me shumicë votash (50% plus 1 votë), me propozim të këshillit të kryesisë.

Neni 20.

Kuvendin e përbëjnë :

1. anëtarët e Kryesisë;
2. kryetarët e këshilleve qytetare dhe komunale;
3. anëtarët e për zgjedhur të degëve komunale në proporcion të cilin e miraton këshilli Kryesisë;
4. asambleistët dhe funksionerët të cilët i zgjedh kuvendi.
5. kryetarët dhe nënkryetarët e këshilleve të Degëve;
6. delegatët e rinisë në numër i cili, para Kuvendit, konstatohet nga këshilli Kryesisë;
8. kryetari i rinisë;
9. anëtarët e përhershëm që përbëjnë këshillin e Kryesisë;

Këshilli Kryesisë

Neni 21.

Këshilli Kryesisë është organi më i lartë i vendim marrjës në Parti ndërmjet dy seancave të Kuvendit. Anëtarët e këshillit të Kryesisë i zgjedhë dhe shkarkon Kuvendi i PKS. Kandidat për anëtarë të këshillit Kryesorë mund të jetë çdo anëtarë i Partisë të cilin e propozojnë minimum dy këshilla komunal, gjashtë anëtarë të këshillit të Kryesisë, Kryesia, Kryetari i Partisë ose dhjetë delegate të Kuvendit. Shkarkimi i anëtarëve të këshillit të Kryesisë inicohet sipas veprimit të njejtë. Detajet e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit të Kryesisë janë të cekura në “Rregullorën e punës të Kuvendit të PKS”. Këshilli Kryesisë takohet së paku një here në katër muaj.

Neni 22.

Këshilli Kryesisë:

1. forcon politikën e PKS;
2. ofron programin zgjedhorë të PKS dhe vendosë për pjesmarrje në zgjedhje në të gjitha nivelet;
3. vendosë për koalicionet zgjedhore në të gjitha nivelet dhe atë thjeshtë me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit të Kryesisë; dhe me propozim të kryesisë së partisë
4. vendosë për bashkimin në aleancë të organizatave, bashkimit me parti tjetër dhe me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe atë me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm të këshillit të Kryesisë;
5. vendosë për pjesmarrje të PKS në Qeveri
6. shqyrton dhe miraton raportin e Kryetarit të Partisë për punën e Partisë ndërmjet dy seancave të këshillit të Kryesisë;
7. ofron planin financiarë të Partisë, me propozim të Kryesisë;
8. disponon me pasurinë e patundshme të Partisë;
9. miraton raportin e funksionimit financiarë;
10. miraton raportin e Kryesisë;
11. edukon komisionet e përhershme dhe të përkohëshme me detyra të caktuara;
12. verifikon mandatin dhe pushimin e mandatit të anëtarëve të saj;
13. thërret Kuvendin e Partisë;
14. themelon fondet, kompanitë dhe subjekte të tjera ligjore në përputhje me ligjin;
15. miraton Rregulloret dhe aktet tjera të përgjithshme të Partisë në kompetencën e saj;
16. i propozon Kuvendit kandidatin për Sekretarin Gjeneral të Partisë;
17. kryen edhe punë tjera në përputhje me këtë Statut dhe me aktet e përgjithshme të Partisë.
18. përcakton vlerën e anëtarësisë për anëtarët e Partisë.

Këshilli Kryesisë në mbledhjen e parë të anëtarëve të përhershëm të këshillit të Kryesisë (11 anëtarëve të Partisë të cilët i zgjedh Kuvendi) emëron 2 anëtarë për anëtarët e Kryesisë.

Këshilli Kryesisë mundet që disa punë nga kompetenca e saj ti delegojë te organet tjera të Partisë.

Neni 23.

Mbledhjet e këshillit të Kryesisë i thërret dhe i kryeson Kryetari i PKS.
Pyetjet rreth punës së këshillit të Kryesisë më detalisht rregullohen me Rregullorën e punës të këshillit të Kryesisë.

Neni 24.

Këshillin e Kryesisë e përbëjnë:

1. anëtarët e Kryesisë
2. kryetarët e këshillëve qytetare dhe komunale;
3. deputetët;
4. anëtarët e qeverisë;
5. bartësi i funksionit më të lartë në qeverisje lokale;
6. 1 përfaqësues i rinisë të PKS;
7. 1 përfaqësues i forumit të gruasë;
8. kryetari i Partisë;
9. përfaqësuesi financiarë i Partisë;
10. anëtarët e përhershëm prej 11 anëtarëve të Partisë të cilët i zgjedhë Kuvendi.

Anëtarësimi në këshillin e Kryesisë ndërpritet në qoftëse anëtari i këshillit të Kryesisë pa arsyetim mungon në dy mbledhje të njëpasnjëshme të këshillit të Kryesisë .

Këshilli Kryesisë është i obliguar që deri në mbajtjen e pare të ardhshme të mbledhjes ti informojë organet e partisë për shkarkimin e anëtarit të këshillit të Kryesisë.

Këshilli Kryesisë mund të zgjedhë anëtarin e ri në përbërjen e këshillit të Kryesisë në qoftëse për këtë deklarohen dy të tretat e shumicës së të pranishmëve.

Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të Kryesisë bëhet me zgjedhje publike.

Kryesia

Neni 25.

Kryesia është trupi operativ i cili kryen dhe përcjell zbatimin e vendimeve të këshillit të Kryesisë.

Kryesia ka 7 anëtarë dhe përbëhet nga Kryetari Partisë, nënkryetarët e Partisë, 2 anëtarë të këshillit të Kryesisë dhe Sekretari Gjeneral i Partisë.

Kryesia takohet së paku një here në muaj dhe për punën e saj i përgjigjet këshillit të Kryesisë.

Neni 26.

Kryesia:

1. përgjigjet për zbatimin e vendimeve të këshillit të Kryesisë;
 2. forcon dhe zbaton politikat e Partisë ndërmjet dy seancave të këshillit të Kryesisë;
 3. kryen kontrollin e punës të përfaqësuesve të Partisë në qeveri;
 4. propozon te këshilli Kryesisë planin financiarë të Partisë dhe përkujdeset për zbatimin e tij;
 5. udhëheqë politikat kadrovike të Partisë, gjegjësisht forcon listen e kandidatëve për deputet, vendosë për mandatet e deputetëve, cakton kandidatët bartës për funksionet më të lartë shtetërorë, emëron kandidatin zgjedhorë të PKS për Kuvendin e Kosovës me propozim të Kryetarit;
 6. propozon kandidatët për të gjitha funksionet të cilat i zgjedhë këshilli Kryesisë;
 7. emëron kryetarin dhe anëtarët e këshillit Politik, këshilli për vetëqeverisje lokale dhe Këshillit për pyetjet e pakicave kombëtare;
 8. forcon resumenë për detyrimet e nënkryetarit;
 9. disponon me pasurinë e patundshme të Partisë;
 10. emëron kryetarin e këshillit të resurseve dhe koordinon punën e tyre;
 11. vendosë rreth qështjeve organizative të punës së Partisë;
 12. formon shtabin Qëndrorë zgjedhorë;
 13. vërteton listen e kandidatëve për asambleistët komunal;
 14. vërteton kandidatin për Kryetarë komune në kuadër të PKS ;
 15. përcjellë, analizon dhe përshtatë punën e organeve lokale të Partisë dhe organeve të vetëqeverisjës lokale dhe propozon masat;
 16. vendosë për themelimin e këshillit në vend dhe jashtë vendit;
 17. shkarkon organet lokale të organizatës dhe emëron përfaqësuesit në këso raste;
 18. vendosë për themelimin e klubeve të PKS-a, me propozimin e këshillit komunal, gjegjësisht këshillit të qytetit;
 19. sjell Rregullorën për punën e tyre;
 20. i propozon këshillit të Kryesisë marrëveshjen e koalicionit me subjekte tjera politike;
 21. kryen edhe punë tjera të cilat i besohen nga këshilli Kryesisë.
- Për pyetjet e rëndësishme (pyetjet e besimit ndaj qeverisë, votimit të buxhetit dhe të ngjashme) me kërkesë të Kryetarit të Partisë së bashku mbajnë mbledhje dhe vendosin për votimin e Kryesisë dhe grupit parlamentarë.

Kryetari Partisë

Neni 27.

Kryetari Partisë është organi politik dhe ekzekutiv i Partisë.

Neni 28.

Kryetari Partisë:

1. udhëheq politikat e Partisë;
 2. paraqet dhe përfaqëson Partinë në vend dhe jashtë vendit;
 3. thërret dhe, sipas rregullave, kryeson mbledhjet e këshillit Kryesorë;
 4. thërret Kuvendin e Partisë;
 5. propozon Kuvendit kandidatët për nënkryetarët e Partisë;
 6. propozon listen e kandidatëve për deputet;
 7. emëron zëdhënësin e Partisë;
 8. emëron përfaqësuesin financiarë të Partisë;
 9. emëron drejtorin Ekzekutiv të Partisë;
 10. sekretarin për marrëdhënje ndërkombëtare;
 11. emëron drejtorin për marrëdhënje me publikun;
 12. paraqet raportin për punën e Partisë tek Kuvendi dhe këshilli Kryesisë;
 13. jape autorizim për përfaqësimin e Partisë para gjykatës ose ndonjë organi tjetër;
 14. thërret dhe kryeson mbledhjet e Kryesisë;
 15. emëron këshilltarët e saj për fushat e caktuara;
 16. kryen edhe detyra tjera të cilat i besohen nga këshilli Kryesisë.
- Kryetari Partisë mund të thërret mbledhje për çdo organ dhe trup në Parti.

Neni 29.

Proqesin e zgjedhjes dhe shkarkimit të Kryetarit të Partisë, më detalisht rregullohet me rregullorën e Kuvendit sipas së cilës kandidati për Kryetarë të Partisë mund të jetë çdo anëtarë i Partisë të cilin e propozon 20% të këshillit Komunal, 10 anëtarët e këshillit të Kryesisë, grupi parlamentarë ose 30 delegatë të Kuvendit. Shkarkimin e Kryetarit të Partisë e inicon 30% të këshilleve Komunale, 50% të delegatëve të këshillit të Kryesisë. Detalet e zgjedhjes dhe shkarkimit të Kryetarit të Partisë janë të cekura në “Rregullorën e punës së Kuvendit të PKS”.

Proqesi zgjedhës për Kryetar të Partisë duhet të sigurojë barazi në proqesin e kandidaturës dhe zgjedhjes të gjithë anëtarëve të Partisë.

Zgjedhja e Kryetarit të PKS bëhet me votim të fshehtë.

Nënkryetarët e Partisë

Neni 30.

PKS ka 3 nënkryetarë të cilët në propozim prej minimum tre këshillave komunale të Partisë zgjedhen në periudhë prej 4 viteve.

Të përzgjedhur konsiderohen ata kandidat të cilët marrin shumicën e votave të delegatëve të pranishëm në Kuvend. Mënyra e zgjedhjes duhet të sigurojë që së paku 1 nënkryetarë të jetë përfaqësues i gjinisë më pak të përfaqësuar. Proqesi zgjedhës dhe shkarkimit të nënkryetarit të Partisë më detalisht rregullohet me Rregullorën e punës së Kuvendit të Partisë.

Neni 31.

Nënkryetarët e Partisë janë të obliguar për zbatimin e politikave të Partisë në fushat e caktuara të Programit të Partisë.

Nënkryetarët e Partisë ndihmojnë Kryetarin në kryerjen e detyrave.

Nënkryetarët për punën e tyre përgjigjen te Kryetari Partisë dhe Kuvendi.

Komisioni Statuor

Neni 32.

Komisioni statuor interpreton vendimet e organeve partiake dhe japë mendim se a janë në përputhje me statutin e partisë.

Komisionin statuor e zgjedh këshilli Kryesisë në periudhë prej kater viteve.

Komisioni statuorë përbëhet prej pesë anëtarëve.

Formimin e organit për zgjidhjen e mosmarrveshjeve brenda partisë në lidhje me interpretimin e statutit.

Sekretari Gjeneral i Partisë

Neni 33.

Sekretari Gjeneral i Partisë:

1. udhëheqë punën e administrates së Partisë;
2. lejon hapjen e xhirrologarisë dhe punimin e vulës organeve të organizatës lokale të Partisë;
3. kryen edhe detyrat tjera të cilat i besohen nga këshilli Kryesisë, Kryesia, Kryetari ose Zëvendës Kryetari i Partisë.

Përfaqësuesi financiarë i Partisë

Neni 34.

Përfaqësuesin financiarë e emëron Kryetari Partisë.

Përfaqësuesi financiarë kryen punët financiare sipas autorizimit të Kryetarit të Partisë.

Përfaqësuesi financiarë është përgjegjës për punën e financimit të Partisë, udhëheqjen financiare, paraqitjen e raporteve, udhëheqjen e librave, nënshkrimin e dokumentave financiare, miratimin e hapjës së xhirrologarisë organizatave lokale partiake dhe është i autorizuar të kontaktojë me organet kompetente shtetërore, në përputhje me rregulloret pozitive financiare.

Përfaqësuesi financiar kryen edhe punët tjera të cilat i besohen nga Kryetari Partisë dhe Zëvendës Kryetari Partisë.

Drejtori ekzekutiv i Partisë

Neni 34a.

Drejtorin ekzekutiv të Partisë e emëron Kryetari Partisë.

Drejtori ekzekutiv i Partisë:

1. kujdeset dhe është vetë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të organeve të Partisë;
 2. punon në themelimin e degëve lokale të Partisë dhe zhvillimit lokal të infrastrukturës partiake në përputhje me drejtimit te cilat i marrin nga Kryetari i Partisë;
 3. punon në ritjen e anëtarësimeve në Parti;
 4. kujdeset për mirëmbajtjen e bazës qendrore të të dhënave të anëtarëve;
 5. është përgjegjës për organizimin e edukimit të anëtarëve;
 6. kryen edhe detyra tjera të cilat i besohen nga Kryetari Partisë.
- Drejtori ekzekutiv i partisë dorëzon raportin te Kryetari Partisë.

Sekretari për marrëdhënie ndërkombëtare

Neni 34b.

Sekretarin për marrëdhënie ndërkombëtare e emëron Kryetari Partisë.

Sekretari për marrëdhënie ndërkombëtare mban marrdhënie, në emër të Partisë me organizata ndërkombëtare politike dhe joqeveritare dhe kryen punë tjera në përputhje me këtë Statut të cilin ja beson Kryetari Partisë.

Sekretari për marrëdhënie ndërkombëtare dorëzon raportin te Kryetari i Partisë.

Drejtori për marrdhënie me mediat

Neni 34c.

Drejtorin për marrdhënie me mediat e emëron Kryetari Partisë.

Drejtori për marrdhënie me mediat mban marrdhëniet me mediat dhe gazetarët, pregaditë njoftimet për publikun, pregaditë konferencat për media, pregaditë paraqitjet publike dhe shfaqet në radio dhe TV kanale të funksionerëve të Partisë, organizon ngjarje, pregaditë hulumtime dhe anketa lokale në interes të Partisë, pregaditë materialin e shtypur përcjellës i cili shfrytëzohet në komunikimin me publikun dhe kryen punë tjera të cilat i besohen nga ana e Kryetarit të Partisë.

Drejtori për marrdhënie me mediat dorëzon raportin tek Kryetari Partisë.

Trupat e partisë

Neni 35.

Trui partisë është: Këshilli politik, Këshilli për vetëqeverisje lokale, Këshilli për qeshtjet e pakicave kombëtare dhe këshillat e resurseve.

Këshilli Kryesisë dhe Kryesia mund të edukojnë edhe trupa tjerë të përhershëm ose të përkohshëm.

Këshilli politik

Neni 36.

Kryetarin dhe anëtarët e këshillit Politik e emëron Kryesia. Kryetari dhe anëtarët e këshillit Politik nuk është e domosdoshme që të jenë anëtarë të PKS.

Këshilli Politik mirret me:

1. pyetje starategjike të zhvillimit të Partisë;
2. pyetjet lidhur me angazhimet e programit dhe konceptet e Partisë;
3. punë politiko hulumtuese.

Këshilli Politik për punën e tij i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë.

Këshilli për vetëqeverisje lokale

Neni 37.

Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit i emëron Kryesia, nga radhët e funksionerëve të qeverisjes lokale dhe ekspertët nga lamia e punëve të rëndësishme për punën e vetëqeverisjes lokale. Kryetari dhe anëtarët e këshillit Politik nuk është e domosdoshme që të jenë anëtarë të PKS.

Këshilli për vetëqeverisje lokale mret me:

1. pregaditjen e propozimeve të dokumentave të programit dhe propozimet e ligjit në lidhje me vetëqeverisjen lokale;
2. pyetjet e funksionimit dhe përparimit të punës për vetëqeverisje lokale në përputhje me Programin e Partisë;
3. analizën e punës së organit për vetëqeverisje lokale dhe propozon masat për zbatimin e programit partiak në këtë lami;
4. përcjellë zbatimin e programit të Partisë nga lamia e vetëqeverisjes lokale në vendimet e organit të Partisë dhe organeve lokale në të cilat marin pjesë anëtarët e Partisë;
5. organizimin e këshillave profesionale, tryezave të rrumbullakëta, tribunave dhe aktiviteteve të ngjashme me qëllim të edukimit të funksionerëve të vetëqeverisjes lokale.

Këshilli për vetëqeverisje lokale për punën e tij i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë.

Këshilli për qeshtje të pakicave kombëtare

Neni 38.

Këshillin për qeshtje të pakicave kombëtare e përbëjnë Kryetari dhe së paku 5 anëtarë të komunitetit pakicë të cilin e emëron Kryesia. Kryetari dhe anëtarët e këshillit Politik nuk është e domosdoshme që të jenë anëtarë të PKS.

Këshilli për qeshtje të pakicave kombëtare mret me:

1. pregaditjen e propozimeve të dokumentacionit të programit dhe propozimet për ligjin në lidhje me statusin e pakicave kombëtare;
2. pyetjet e funksionimit të organeve shtetërore dhe aritjës së të drejtave për pakicat kombëtare në përputhje me standardet europiane;
3. organizimin e këshillave profesionale, tryezave të rrumbullakëta, tribunave dhe aktiviteteve tjera me qëllim të këmbimit të mendimeve dhe krijimit të bashkpunimit me minoritetet tjera.

Këshilli për qeshtje të pakicave kombëtare për punën e tij i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë.

Këshilli i resurseve

Neni 39.

Këshilli i resurseve organizon punën e ekspertëve të lamive të ndryshme me qëllim të përparimit të funksionimit të Partisë dhe qeverisjes.

Këshillet e resurseve kanë për detyrë të:

1. propozojnë dokumentet për programin e PKS nga lamitë e ndryshme, ofrojnë dituri shkencore dhe profesionale, Informacione dhe sugjerime për aktivitetet partiake;
2. propozojnë zgjidhjen e pyetjeve teorike dhe praktike të rëndësishme për funksionimin e shtetit;
3. edukojnë dhe pregadisin anëtarët e Partisë dhe funksioneve shtetërore;
4. ndihmojnë deputetëve dhe funksionerëve në punën e tyre.

Deputetët, ministrat dhe zavendës ministrat janë sipas funksionit anëtarë të atyre këshilleve të resurseve të cilit i përgjigjen me detyrat e tyre parlamentare dhe ministrore.

Krijimi dhe puna e këshilleve të resurseve rregullohen me aktin e Kryesisë.

Organizata Lokale

Neni 40.

PKS në nivelin lokal dhe qëndrorë politikën e saj e zbaton nëpërmjet:

1. Këshilleve të bashkësive lokale;
2. Këshillit Komunal;
3. Këshilli qytetit.

Organet lokale organizojnë dhe promovojnë programin e Partisë në pjesët në të cilat veprojnë, organizojnë dhe pranojnë anëtarë të rinj, gjegjësisht zbatojnë politikën në nivelin e tyre në përputhje me Statutin, Programin dhe vendimet e Partisë.

Pyetjet e organizimit dhe veprimit të organeve lokale të Partisë rregullohen me Rregullorën e organizimit lokal të PKS, të cilin e miraton Kuvendi Komunal.

Kandidatë zgjedhorë mund të jenë personat me të drejtë vote në Kosovë, pjestarë të të gjitha bashkësive nacionale, personat autoritativ, të cilët nuk janë të denuar apo të përndjekur penalisht.

Grupi Parlamentarë

Neni 41.

Grupi Parlamentarë:

1. zbaton politikën e Partisë në Kuvend;
2. shqyrton të gjitha qështjet nën juridiksionin parlamentarë dhe inicon aktivitete legjislative;
3. vendos për votimin e deputetëve për të gjitha qështjet e rendit të ditës të seancës parlamentare,
4. zgjedh kryetarët e grupeve;
5. emëron sekretarin e grupit.

Grupi Parlamentarë është i obligueshëm të respektoj politikën e Partisë dhe të zbatojë vendimet e Kuvendit, këshillit të Kryesisë dhe Presidencës.

Në qoftëse vie deri te konflikti ndërmjet Kryesisë dhe grupit Parlamentarë, vendos këshilli Kryesisë.

Neni 42.

Deputetët janë të obligueshëm që të votojnë në përputhje me vendimin e grupit parlamentarë.

Nëse deputetët në mënyrë të vrazhdë thejnë obligimet e tyre parlamentare dhe nuk i përmbahen vendimeve të grupit të tyre Parlamentarë, grupi Parlamentarë mund të kërkojë nga Kryesia që atyre deputetëve ti ndërpritet mandati.

Të drejtat dhe obligimet e deputetëve dhe grupeve parlamentare rregullohen me rregullorën të cilën e miraton Kryesia.

Forumi Gruasë

Neni 43.

Forumi gruasë është organizatë vullnetare të cilën e përbëjnë anëtarët e PKS.

Forumi i gruasë zgjedhë kryetarën e Forumit dhe Këshillin e Forumit të cilin e përbëjnë së paku 5 anëtare.

Forumi gruasë muret me gjendjen dhe të drejtat e gruasë në shoqëri dhe realizimin e drejtave të gruas në përputhje me standardet dhe konventat europiane, si dhe veprimtarisë më të përfaqësuar të gruasë në ngjarjet politike dhe bën përpjekje për ndikim më të madhë të tyre në marjën e vendimeve të rëndësishme.

Organizata dhe veprimtaria e Forumit të Gruasë rregullohet me rregullorën të cilën e miraton Këshilli Kryesisë i PKS, në propozim të Konferencës së Forumit të gruasë.

Rinia PKS-a

Neni 44.

Rinia e Partija e Serbeve te Kosoves është organizatë vullnetare e anëtarëve të PKS, më të rinjë se 30 vjeçarë. Organizimi dhe veprimtaria e rinisë rregullohet me rregullorën të cilin e miraton Këshilli Kryesisë i PKS, në propozim të Konferencës së rinisë së PKS.

Finansimi i PKS

Neni 45.

Partia krijon mjete për veprimtaritë e saj nga:

1. anëtarësimi; ;(1€ në muaj, gjegjësisht 12€ në nivel vjetorë)
2. kontributet;
3. dhuratat;
4. trashëgimitë;
5. buxheti;
6. burimeve tjera, në pajtim me ligjin.

Subjekti politik “PKS” e ka vetëm një xhirollogari.

Këshilli Kryesisë miraton planin financiarë të Partisë, në propozim të Kryesisë.

Partia udhëheq punën e saj materialo-financiare nëpërmjetë xhirollogarisë në pajtim me ligjin.

Vlera e anëtarësimit caktohet në përputhje me fuqinë ekonomike të anëtarëve me vendim të Këshillit të Kryesisë për vitin kalendarik.

Marrëdhënjet reciproke në drejtim të alokimit të partisë Qëndrore dhe këshilleve Komunale, si dhe qështjet tjera lidhur me anëtarësimin më detalisht rregullohen me Rregullorën për anëtarësimin dhe vendimeve të veqanta të organeve të Partisë.

Këshilet Qytetare dhe Komunale janë të obliguar që dy herë të paraqesin raportin drejtorit të financave të Partisë për funksionimin financiarë.

Përfaqësuesi financiar i Partisë paraqet Raportin tek kontrolli i brendshëm për veprimtarinë e Partisë, Këshillit të Kryesisë dy herë në vitë sipas barazimit gjashtëmuorë dhe vjetorë.

Aktet e Përgjithshme të Partisë

Neni 46.

Aktet e Përgjithshme të Partisë janë:

1. Statuti;
2. Rregullorja e Kuvendit;
3. Rregullorja e këshillit të Kryesisë;
4. Rregullorja e përgjegjësisë së anëtarëve të Partisë;
5. Rregullorja e organizimit lokal ;
6. Akte tjera të përgjithshme.

Pushimi dhe ripërtrirja e veprimtarive

Neni 47.

PKS mund të ndërprejë ekzistimin e saj në qoftëse 2/3 e të gjithë delegatëve votojnë për, në mbledhjen e rregullt ose të jashtëzakonshme të Kuvendit të PKS. Në rast të pushimit-ndërprerjes së veprimtarisë në nenin 1 të këtij neni, gjegjësisht në rastin e shpërbërjes së PKS, kjo do të thotë sa veprimtaria e cila ekziston në mjetet financiare mund të jetë e ndarë tek organizatat humanitare nëpërmjet vendimit të veçant të miratuar nga ana e organit të veçant për shpërbërjen e PKS.

Vendimin e ndërprerjes dhe ripërtrirjes së veprimtarisë së PKS e miraton këshilli Kryesisë.

Miratimi i Statutit

Neni 48.

Proqesi i miratimit të Statutit mund ta inicojnë këshilli Kryesisë dhe Kryesia.

Komisioni Statuor pregaditë dhe dorëzon draft Statutin i cili i udhëzon të gjithë organet në Parti për diskutim, i cili zgjatë së paku 20 ditë.

Pas mbajtjes së debateve publike në organet e Partisë, në bazë të vërejtjeve të cilat kanë aritur, komisioni Statuor krijon draft Statutin të cilin ja dorëzon këshillit të Kryesisë në shqyrtim. Pas shqyrtimit, këshilli Kryesisë e vërteton propozimin e Statutit dhe e dorëzon në miratim, tek Kuvendi i Partisë.

Kuvendi e miraton Statutin me shumicë votash të delegatëve të pranishëm.

Modifikimet dhe plotësimet e Statutit bëhen në mënyrën dhe procedurën e miratimit të saj.

Në qoftë se nuk ka mosmarrveshje në mes të subjekteve politike, ndarja e patundshmërisë do të bëhet nga ana e gjykatës kompetente.

Hyrja në fuqi

Neni 49.

Ky Statut hynë në fuqi ditën e miratimit të tij.

Shfuqizimi i Statutit

Neni 50.

Me hyrjen në fuqi të Statutit të ri apo të modifikuar shfuqizohen rregullat e Statutit të vjetër ose pjesët e statutit të cilat janë modifikuar me vendimin e Kuvendit të partisë.

Vlefshmëria e akteve

Neni 51.

Rregullat e akteve të përgjithshme të PKS të cilat nuk janë në përputhje me këtë Statut nuk do të zbatohen.

Të gjitha aktet e përgjithshme të PKS duhet të jenë në pajtim me këtë Statut në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve.